



BUXHETIMI ME PJESËMARRJE

Sfidat dhe mundësitë e praktikave të
mira të buxhetimit me pjesëmarrje në
qeverinë lokale në Kosovë





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2022. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Hulumtues: Naim Cahanaj

Asistente Hulumtuese: Elmedina Dorambari

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center (OPC). Opinione, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE – QËLLIMI - **6**
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE - **7**
3. SFONDI - **9**
4. PRAKTIKAT E DËGJIMEVE BUXHETORE NË NIVEL LOKAL – RASTI I KOSOVËS - **12**
5. IDENTIFIKIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA NË ORGANIZIMET E DËGJIMEVE BUXHETORE - **16**
6. REKOMANDIMET PËR KOMUNA - **19**
7. BURIMET - **20**



1. HYRJJE

1.1 Qëllimi

Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal vazhdon të jetë sfidë në rastin e komunave të Kosovës. Ky fakt, nuk vije si shkak i mos konsolidimit të bazës ligjore, por nga fakti se komunat e Kosovës vazhdojnë të mos e shohin të rëndësishme pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, duke mos pasur angazhime konkrete në fuqizimin e mekanizmave të brendshëm për rendësinë e jetësimit dhe zbatimit të pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të qytetarëve në hartimin dhe zbatimin e politikave publike, e posaçërisht në procese të rëndësishme të planifikimit të buxhetit komunal.

Në tentativë për të respektuar mekanizmat ligjor për përfshirjen e qytetarëve në procesin e planifikimit të buxhetit, qeveritë lokale në nivel vendi kanë zbatuar praktika solide në organizimin e dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit komunal. Gjatë vitit 2020, në 26 komuna, 198 takime janë realizuar për buxhet dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB).¹

Praktikat e tilla në organizimin e dëgjimeve buxhetore, kryesisht mbeten në fazën e informimit të qytetarëve mbi planifikimin e buxhetit nga ana e qeverive lokale. Përkundër rritjes së numrit të dëgjimeve buxhetore nga viti në vit, forma dhe mënyra e organizimit aktual të dëgjimeve buxhetore nga qeveritë lokale pamundëson një analizë dhe reflektim mbi atë se sa janë marrë për bazë dhe sa janë reflektuar në projeksionet buxhetore kërkesat e qytetarëve. Për më tepër, komunat nuk kanë fuqizuar ndonjë mekanizëm standardizues, për t'i ndihmuar vetë institucioneve lokale në planifikim të buxhetit me pjesëmarrjen e gjerë të publikut.

Hulumtimi i tillë ka për qëllim të jep një pasqyrë më të gjerë për konceptin e buxhetimit me pjesëmarrje, të analizoj in-

frastrukturën aktuale në nivel vendi për obligimet që duhet të përmbushin komunat në raport me përfshirjen e qytetarëve në proces të buxhetimit me pjesëmarrje, praktikat aktuale në rastin e Kosovës, gjetja e praktikave të mira në rajon dhe me gjerë si dhe dhënien e rekomandimeve për institucionet lokale dhe qendrore për të përmirësuar dhe ndryshuar politikat aktuale të buxhetimit me pjesëmarrje.

1.2 Metodologjia – Metodrat

Metodologjia e hartimit të këtij hulumtimi bazohet në një proces ku është hulumtuar literatura nga autorë dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare për konceptet e përgjithshme të buxhetimit me pjesëmarrje, vlerësimet e ndryshme në raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare për historikun dhe praktikrat e mira të buxhetimit me pjesëmarrje, analizën e infrastrukturës ligjore në planifikimin e buxhetit me pjesëmarrje në rastin e Kosovës, praktikrat aktuale dhe sfidat e qeverive lokale në këtë proces përmes shfrytëzimit të të dhënave nga raporte të ndryshme si nga ana e institucioneve ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile.

¹ Raporti i performancës së komunave të Republikës së Kosovës 2020, MAPL, 2021, fq. 16, <https://mapl.rks-gov.net/performance-komunale/>



2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Buxheti me pjesëmarrje përfaqëson një qasje me demokraci të drejtpërdrejtë ndaj planifikimi të buxhetit. Buxheti me pjesëmarrje gjithashtu forcon qeverisjen gjithëpërfshirëse duke u dhënë mundësi grupeve të marginalizuara dhe të përjashtuara t'u dëgjohet zëri dhe të ndikojnë në vendimmarrje publike e cila është jetike për interesat e tyre. "Buxheti me Pjesëmarrje" (BP) përfshinë drejtpërdrejt banorët në marrjen e vendimeve për prioritetet e shpenzimeve për një buxhet të përcaktuar publik. Kjo nënkupton angazhimin e banorëve dhe grupeve të komunitetit, përfaqësuesve të të gjitha pjesëve të komunitetit, për t'i diskutuar prioritetet e shpenzimeve, për të bërë propozime për shpenzimet dhe për t'i votuar ato.


Duke marrë për bazë praktikën e ndryshme në nivel global dhe regional, modeli i Porto Alegre, modeli i Bashkisë së Elbasanit si dhe modeli i komunave në Gjermani, mbeten ndër modelet më të zhvilluara në Buxhetimin me Pjesëmarrje. Nën buxhetimin me pjesëmarrje të stilit të Porto Alegre, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile marrin pjesë drejtpërdrejt në marrjen e vendimeve buxhetore përmes një cikli njëvjeçar të forumeve masive të qytetarëve, **asambleve tematike që trajtojnë çështje specifike, si shëndetësia dhe arsimit, dhe zgjedhjen e delegatëve të përkushtuar qytetarë, të cilët formojnë një Këshill të Buxhetimit me Pjesëmarrje, i cili shqyrton propozimin përfundimtar të buxhetit.** Procesi përdoret për alokimin e burimeve buxhetore (duke përdorur një skemë sasiore për t'i prioritetizuar shpenzimet sipas nevojave dhe preferencave), caktimin e prioritetëve të gjera të politikave sociale dhe ekonomike dhe monitorimin e shpenzimeve publike.

Në modelin të Bashkisë së Elbasanit, planifikimi i buxhetit bëhet duke informuar qytetarët sa do të jetë vlera e investi-

mit që do të prekë njësinë përkatëse ku prezantohet ky buxhet, dhe nëse banorët kërkojnë ndryshime të investimeve, këto regjistrohen dhe më pas përfshihen në zërin e buxhetit përfundimtar. Në takimet publike të realizuara për çdo njësi, në vendin e caktuar paraprkishtë nga administratori, **qytetarët votojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për prioritetet në nevojë për investime. Në takimet në fjalë zgjidhen dhe komisionarët me bazë njësie, të cilët ndihmojnë në realizimin sa më transparent të buxhetimit me pjesëmarrje. Në takimet vijuese të komisionarit dhe stafit të bashkisë, bëhet vlerësimi i prioritetëve nëpërmjet përcaktimeve të kërkuara nga rregullorja e buxhetimit me pjesëmarrje.**

Në modelin e komunave në Gjermani, kemi praktika të ndryshme të komunave që cdo herë kanë ardhur duke u avancuar. Kësisoj, komuna Berlin-Lichtenberg, buxhetimin me pjesëmarrje filloj të praktikoj që nga viti 2007, me një grup inovativ të institucioneve. Për buxhetimin me pjesëmarrje, kjo komuna themelon katër (4) Komitete ku bashkëpunojnë në buxhetimin me pjesëmarrje:

- **Ekipi menaxhues** i projektit funksiononte si organ i brendshëm koordinues brenda administratës së ndarjes administrative, duke përfshirë drejtorët e shërbimit drejtues si dhe të shërbimeve personale dhe financiare të administratës së ndarjes administrative.
- **Komitete drejtues** si organ qendror vendimmarrës me shtatë anëtarë: tre nga administrata e ndarjes administrative (përfshirë kryetarin e komunës) dhe katër që përfaqësonin katër grupet parlamentare të kuvendit të ndarjes administrative. Nën drejtimin e saj dhe së bashku me komitetet e tjera u zhvillua koncepti i buxhetit të qytetarëve dhe u përcaktua "rregullorja e punës". Komiteti dre-



jtues pranoi rezultatet e ekipit të projektit dhe vendosi unanimisht për kërkesat për zgjidhje.

- **Ekipi i projektit** si organ punues u themelua me 12 anëtarë me të drejta të barabarta: katër përfaqësues të qytetarëve (nga degët për rini, të moshuar, migrantë dhe gra), katër këshilltarë të ndarjes administrative dhe katër përfaqësues të njësive të përfshira administrative të ndarjes administrative.
- **Ekipi redaktues** për analizimin dhe plotësimin e sugjerimeve të qytetarëve përfshiu dhjetë qytetarë, të cilët u përzgjedhën në pesë takimet tremujorëve. Ata morën mbështetje nga nëpunësit civilë të administratës së ndarjes administrative.

Në anën tjetër, Ligji për vetëqeverisje lokale në Kosovë, pos në mbajtjen e dy takimeve publike, obligon komunat t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës. Përveç dy takimeve publike, Komuna obligohet në mbajtjen e takimeve tjera konsultative në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera për çështjet që lidhen me buxhetin e komunës. Projekt-buxheti i komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor, Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për 3 vitet e ardhshme, mbasin dokumente ku komunat obligohen t'a konsultojnë publikun/ qytetarët dhe në kuadër të organizimit të konsultimit të tillë publik për këto dokumente, zyrtarët më të lartë të organeve të komunës (Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryesuesit e Komiteteve dhe komisioneve përkatëse të kuvendit të komunës) mund të marrin pjesë. Në anën tjetër, **komunat kanë për obligim të komunikimit të vazhdueshëm me qytetarët në proces të konsultimit të politikave publike / buxhetit komunal**. Një nga obligimet e tilla mbetet në përgjegjësin e mbledhjes dhe përgatitjes së raportit për rezultatet e konsultimit publik. **Një nga pikat më të rëndësishme në proces të konsultimit publik mbetet analizimi i pranimin apo refuzimin e rekomandimeve (kërkesave/propozimeve) nga ana e qytetarëve në procesin e konsultimit publik**, i cili domosdo duhet të finalizohet si proces nga grupi punues i projekt propozimit të buxhetit komunal (drejtoria për ekonomi dhe financa). Komuna po ashtu është e obliguar që në afat prej më se paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim, të përpilojë raport nga shqyrtimi publik i projekt buxhetit komunal, ku përfshihen të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sygjerimet e publikut. Raporti i tillë

duhet të publikohet në ueb faqen e komunës si dhe duhet të paraqitet në kuvendin e komunës para aprovimit të projekt propozimit të buxhetit komunal.

Referuar të dhënave për numrin e takimeve publike, për qëllime të diskutimeve buxhetore, konsultimet me qytetarë janë mbajtur në 26 komuna, me gjithsej 198 takime të realizuara për buxhet dhe KAB, apo mesatarisht 7 takime për komunë. Në bazë të hulumtimeve të kësaj fushe, arsytet e mospjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike, krahas pandemisë, kryesisht lidhen me: mos planifikimin e mirëfillt të konsultimeve publike; mungesën e koordinimit dhe zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik, **mos përgatitjen e raporteve për rezultatet e konsultimit publik ku kontribut-dhënësve u jepen informata për pranimin ose jo të propozimeve të tyre; mungesën së një debati të strukturuar përgjatë konsultimeve; sistemimit jo të duhur të dokumenteve dhe informatave bazë në platformat online, mos prezencës së stafit politik në takime publike, si dhe mosshfrytëzimit të formave alternative për marrjen e pikëpamjeve të lokaliteteve.**



3. SFONDI

Buxhetimi me pjesëmarrje përfaqëson një qasje me demokraci të drejtpërdrejtë ndaj planifikimi të buxhetit. Ai u ofron qytetarëve, në përgjithësi, një mundësi për të mësuar rreth veprimeve të qeverisë dhe për të diskutuar, debatuar dhe ndikuar në alokimin e burimeve publike. Ai është një mjet për edukimin, angazhimin dhe fuqizimin e qytetarëve si dhe forcimin e kërkesës për qeverisje të mirë. Transparenca dhe llogaridhënia e shtuar që krijon buxhetimi me pjesëmarrje mund të ndihmojë në uljen e jo-efikasitetit të qeverisë dhe frenimin e klientelizmit, patronazhit dhe korrupsionit. Buxhetimi me pjesëmarrje gjithashtu forcon qeverisjen gjithëpërfshirëse duke u dhënë mundësi grupeve të marginalizuara dhe të përjashtuara t'u dëgjohet zëri dhe të ndikojnë në vendimmarrje publike e cila është jetike për interesat e tyre. Buxhetimi me pjesëmarrje vjen me rreziqe të konsiderueshme. Ndërsa rregullat e lojës në një program buxhetor me pjesëmarrje përfaqësuese ndryshojnë nga qyteti në qytet dhe nga shteti në shtet, Wampler identifikon parimet udhëheqëse të programeve të buxhetimit me pjesëmarrje: Komuna është e ndarë në rajone për të lehtësuar takimet dhe shpërndarjen e burimeve. Mbledhjet e sponsorizuara nga qeveria mbahen gjatë gjithë vitit, duke mbuluar aspekte të ndryshme të cikleve të buxhetimit dhe politikë bërjes: shpërndarja e informatave, propozimet e politikave, debatet mbi propozimet, përzgjedhja e politikave, përzgjedhja e delegatëve dhe mbikëqyrja.²

Një "Indeks i Cilësisë së Jetës" krijohet nga qeveria për të shërbyer si bazë për shpërndarjen e burimeve. Rajonet me shkallë më të lartë varfërie, popullsi më të dendur dhe me më pak infrastrukturë ose shërbime qeveritare marrin një përqindje më të lartë burimesh sesa lagjet në gjendje ekonomike më të mirë dhe më të pasura. Secila komunë krijon formulën e saj për të garantuar shpërndarjen e barabartë të burimeve.

Diskutimi dhe negociatat publike mbi burimet dhe politikën, zhvillohen ndërmjet pjesëmarrësve dhe ndërmjet pjesëmarrësve dhe qeverisë. Një varg i gjerë i prioriteteve zhvillohet, në të cilin përfaqësuesit e zgjedhur vizitojnë të gjitha lokacionet e projektit të miratuara paraprakisht, para votimit përfundimtar. Vizitat u mundësojnë delegatëve të vlerësojnë nevojat sociale të projekteve të propozuara. Përfaqësuesit e zgjedhur votojnë për të gjitha projektet përfundimtare. Votimi mund të bëhet me votim të fshehtë ose nëpërmjet ngritjes publike të duarve. Rezultatet bëhen pjesë e të dhënave publike. Zgjidhet këshilli i përgjithshëm komunal. Të gjitha rajonet zgjedhin dy përfaqësues në këtë këshill, i cili mbikëqyr buxhetimin me pjesëmarrje dhe bën rekomandimet përfundimtare të buxhetit. Këshilli takohet rregullisht me qeverinë komunale për ta monitoruar programin. Pas miratimit përfundimtar të buxhetit vjetor nga delegatët e buxhetit me pjesëmarrje, kryetari i komunës ia dërgon atë dhomave komunale legjislative për ta miratuar. Dega legjislative mund të bllokoi projekte specifike. Publikohet një raport në fund të vitit, i cili detajon zbatimin e punëve dhe programeve publike. Krijohen komitete rajonale ose të lagjeve që monitorojnë zbatimin e projekteve. Wampler argumenton se akterët politikë dhe ata socialë kanë motivime të ndryshme për të promovuar dhe për të marrë pjesë në buxhetimin me pjesëmarrje.

Qeveritë lokale zbatojnë programe buxhetore me pjesëmarrje për të ndërtuar një bazë të mbështetjes politike, për të arritur një shpërndarje më të barabartë të burimeve të pamjaftueshme, për të nxitur të mësuarit publik dhe për të promovuar transparencën në qeverisje. Qytetarët marrin pjesë në programet e buxhetimit me pjesëmarrje për ta rritur qasjen në aktivitetet vendimmarrëse publike, për të fituar qasje në informata dhe për ta përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara në kuadër të sistemit të buxhetimit

² Shah, Anwar. Participatory budgeting. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore, 2007, fq.1-2. Linku: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/635011468330986995/pdf/394980REVISSED0101OFFICIAL0USEONLY1.pdf>



me pjesëmarrje. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) marrin pjesë në mënyrë që të ndërtojnë rrjete më të gjera mbështetësish dhe të rrisin aftësinë e tyre për të ndikuar në politika.³

Çfarë është buxhetimi me pjesëmarrje?

Përkufizimi zyrtar është: "Buxhetimi me Pjesëmarrje (BP) përfshin drejtpërdrejt vendastit në marrjen e vendimeve për prioritetet e shpenzimeve për një buxhet të përcaktuar publik. Kjo nënkupton angazhimin e banorëve dhe grupeve të komunitetit, përfaqësuesve të të gjitha pjesëve të komunitetit, për t'i diskutuar prioritetet e shpenzimeve, për të bërë propozime për shpenzimet dhe për t'i votuar ato." Me një fjalë, BP i fuqizon banorët lokal që të luajnë një rol kyç për të vendosur se si shpenzohen paratë publike për projekte dhe shërbime në lagjet e tyre. Në praktikë, kjo mund të variojë nga financimi i komunitetit dhe grupeve vullnetare për të ofruar projekte me vlerë lokale deri tek ofrimi i mundësive që banorët të zgjedhin se çfarë shërbime ofrohen dhe si ofrohen shërbimet kryesore në zonat e tyre.

Që BP të jetë me të vërtetë efektive, ajo duhet të jetë një proces i përsëritur dhe jo pilotim që ndodh vetëm një herë. Nëpërmjet secilit cikël, procesi rafinohet dhe përmirësohet për t'i shërbyer më së miri zonës së caktuar lokale, dhe, si rrjedhim, është edhe një proces i të mësuarit. BP ka origjinën në Brazil në vitet 1980, por është përhapur me shpejtësi në mbarë botën. Shembujt përfshijnë buxhetet e banimit social në Toronto, Kanada; buxhetet e shkollave në PoitouCharentes, Francë; në Ganë dhe Indi për ta reduktuar korrupsionin dhe për ta rritur transparencën e qeverisë; në Berlin i cili ka filluar të përdor metoda që përfshijnë BP në internet; dhe tani po përhapet në Mbretwrinw e bashkuar.⁴

Procesi i BP kërkon angazhimin e qytetarëve në të gjitha fazat e ciklit buxhetor, të përshkruara shkurtimisht më poshtë:

- Identifikimi i investimeve kapitale dhe projekteve për adresimin e nevojave më urgjente lokale;
- Përgatitja e studimeve të fizibilitetit për të mbështetur vlerësimin e investimeve dhe projekteve të tilla;
- Përgatitja e një propozim-buxheti për dorëzim, nëpërmjet kryetarit lokal të komunës tek këshilli lokal;
- Mbikëqyrja e procesit të miratimit të buxhetit (rishikimi, diskutimi dhe votimi);
- Monitorimi i ekzekutimit të buxhetit;
- Monitorimi i prokurimit (tenderimi, ofertimi dhe kontraktimi) dhe
- Monitorimi dhe vlerësimi i kryerjes së punëve publike.

Buxhetimi me pjesëmarrje përfshinë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe shoqërisë civile. Ai gjithashtu angazhon në mënyrë aktive akterë të qeverisjes lokale si kryetarin e komunës, këshillin lokal, thesarbajtësin dhe drejtorët e departamenteve të financave lokale, planifikimit urban dhe rural dhe shërbimeve lokale. BP krijon mundësi për përfshirjen e qytetarëve në vendimet e politikave, përmirëson efikasitetin e alokimit të burimeve dhe rrit cilësinë dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike.⁵

Buxhetimi me pjesëmarrje është njohur nga Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID), Banka Botërore, OKB-ja, UNESCO dhe organizata të tjera për efektivitetin e tij në përmirësimin e transparencës dhe qeverisjes. Buxhetimi me pjesëmarrje konsiderohet si një mekanizëm efektiv i llogaridhënies sociale që forcon anën e kërkesës për qeverisje më të mirë dhe fuqizon qytetarët të ndikojnë në vendimet e sektorit publik, veçanërisht qytetarët e përjashtuar nga shoqëria. Buxhetimi me pjesëmarrje njihet për përmirësimin e reformës së sektorit publik në menax-

3 Shah, Anwar. Participatory budgeting. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore, 2007, fq.3. Linku: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/635011468330986995/pdf/394980REVISED0101OFFICIAL0USE00ONLY1.pdf>

4 Silverlock, Leslie. Participatory Budget Associate. A Toolkit for Participatory Budgeting in the UK, Second Edition, janar 2010, fq.4. Linku: <https://pbnetwork.org.uk/wp-content/uploads/2016/02/Participatory-Budgeting-Toolkit-2010.pdf>

5 Participatory budgeting toolkit for local governments in Albania (English). Washington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore. Linku: <http://documents.worldbank.org/curated/en/1113141468193759381/Participatory-budgeting-toolkit-for-local-governments-in-Albania>



himin e shpenzimeve publike. Nëpërmjet BP, qeveritë lokale kanë demonstruar disiplinë të përmirësuar fiskale, duke gjetur mënyra për t'i ulur kostot, për t'i alokuar investimet në mënyrë më të drejtë dhe për ta rritur transparencën në alokimin, shpenzimin dhe raportimin e buxhetit.⁶

Përfitimet e mundshme të buxhetimit me pjesëmarrje

Rritja e efektivitetit në targetimin e buxhetit: Në shumë raste, buxhetet publike nuk pasqyrojnë prioritetet reale të qytetarëve, veçanërisht ato të të varfërve. Burimet e pamjaftueshme publike shpesh shpenzohen për mallërat e gabuara ose për grupin e gabuar të përfituesve. BP ndihmon në përshtatjen e nevojave të qytetarëve me burimet publike.

Transparencë dhe llogaridhënie e përmirësuar: Shpesh qytetarët nuk kanë qasje në informatat e buxhetit të qeverisë. Në disa raste, qytetarët i perceptojnë buxhetet si shumë të ndërlikuara për t'u kuptuar plotësisht. BP ofron një mundësi qeverive lokale që ta thjeshtësojnë buxhetin për qytetarët dhe që të jenë më transparente dhe më llogaridhënëse në menaxhimin e burimeve publike.

Promovimi i përfshirjes sociale, reduktimi i varfërisë dhe fuqizimi: Procesi tradicional i buxhetimit shpesh mund të kontribuojë në përjashtimin social dhe varfërinë për shkak të kapjes nga elita, grupeve lobuese dhe interesave të fuqishme. Duke u dhënë qytetarëve të zakonshëm dhe grupeve më të cënueshme mundësinë për ta ngritur zërin, BP potencialisht mund t'i ridrejtojë investimet publike drejt shërbimeve bazë në lagjet e varfra. Mekanizmat e të mësuarit social dhe të mobilizimit qytetar të mishëruar në BP ndihmojnë në fuqizimin e grupeve të cënueshme për ta ngritur zërin e tyre në vendimet e buxhetit.

Dëshmitë tregojnë se nuk ekziston një model i vetëm i buxhetimit me pjesëmarrje. Në Shqipëri, përvoja është ende në fillimet e saj dhe është në fazë zhvillimi. Buxheti me pjesëmarrje nuk duhet parë si zgjidhje për të gjitha problemet e qeverisjes lokale. Përkundrazi, ai plotëson mekanizmat tradicional të sektorit publik të llogaridhënies politike, administrative dhe ligjore.

Kush merr pjesë në procesin e BP?

Buxheti me pjesëmarrje është, në fakt, një proces i bashkë menaxhuar. Me fjalë të tjera, është një mekanizëm përmes të cilit akterët shtetërorë dhe ata jo-shtetërorë bashkohen për t'i alokuar, shpenzuar dhe llogaritur burimet publike. Nëse procesi i BP është arritja e objektivave të tij, të gjitha palët e interesit duhet të përfshihen. Këtu përfshihen qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile lokale, qeveria, këshillat lokalë dhe komuniteti biznesor.

Procesi i pjesëmarrjes duhet të sigurojë që grupet e cënueshme (zakonisht qytetarët nga grupet me të ardhura të ulëta, gratë, të rinjtë, fëmijët dhe emigrantët) të angazhohen drejtpërdrejt në të gjitha fazat e BP. Pjesëmarrja në BP është vullnetare dhe të gjitha palët e interesit duhet të gëzojnë mundësi të barabarta për të marrë pjesë. Prandaj, është jetike që të krijohen mekanizmat e duhur në mënyrë që çdo palë e interesit të mund të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë, përmes dëgjimeve publike në nivel lagjeje ose fshati ose takimeve të komunitetit me grupe të veçanta (të tilla si gratë). Prandaj, është e rëndësishme të kuptohen akterët, rolet e tyre dhe motivimet e tyre në mënyrë që të mbështetet pjesëmarrja e tyre.⁷

⁶ Po aty

⁷ Participatory budgeting toolkit for local governments in Albania (English). Washington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore, fq.3. Linku: <http://documents.worldbank.org/curated/en/113141468193759381/Participatory-budgeting-toolkit-for-local-governments-in-Albania>



Komunat kanë për obligim të komunikimit të vazhdueshëm me qytetarët në proces të konsultimit të politikave publike / buxhetit komunal.

tive me qytetarë, shpjegon përmbajtjen e projekt-propozimit para publikut dhe në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për konsultim publik, evidenton propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve.¹³

Në anën tjetër, **komunat kanë për obligim të komunikimit të vazhdueshëm me qytetarët në proces të konsultimit të politikave publike / buxhetit komunal.** Një nga obligimet e tilla mbetet në përgjegjësin e mbledhjes dhe përgatitjes së raportit për rezultatet e konsultimit publik. Një nga pikat ma me rëndësi në proces të konsultimit publik mbetet analizimi i pranimit apo refuzimit të rekomandimeve (kërkesave/propozimeve) nga ana e qytetarëve në procesin e konsultimit publik, i cili domosdo duhet të finalizohet si proces nga grupi punues i projekt propozimit të buxhetit komunal (drejtoria për ekonomi dhe financa).¹⁴

Komuna po ashtu është e obliguar që në afat prej më se paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim, të përpilojë raport nga shqyrtimi publik i projekt buxhetit komunal, ku përfshihen të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sygjerimet e publikut. Raporti i tillë duhet të publikohet në ueb faqen e komunës si dhe duhet të paraqitet në kuvendin

e komunës para aprovimit të projekt propozimit të buxhetit komunal.¹⁵

Përgjegjësit institucionale në planifikimin e buxhetit komunal

Kuvendi i komunës si organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale, në mes tjera nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për miratimin e buxhetit dhe planeve investuese.¹⁶ Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, **buxhetin vjetor afatmesëm** dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.¹⁷ Raporti nga konsultimet publike të planifikimit të buxhetit, duhet të paraqitet në kuvendin e komunës para aprovimit të projekt propozimit të buxhetit komunal.¹⁸

Në anën tjetër, kryetari i komunës, në mes tjerash ka përgjegjësi në udhëheqjen e ekzekutivit të komunës dhe ad-

13 Po aty Neni 16 paragrafi 5 dhe 6

14 Shih Nenin 17 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06 / 2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

15 Po aty Neni 17

16 Po aty Neni 40 paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

17 Neni 52 paragrafi 2 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

18 Shih Nenin 17 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06 / 2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>





ministratën e saj si dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës, ekzekuton aktet e kuvendit të komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, **propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar**.¹⁹

Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës. Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren e Parë Buxhetore 2020/01, ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin pasues dhe vlerësimet për dy vitet tjera, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar buxhetor për vitin pasues dhe vlerësimet për dy vitet tjera për çdo Organizatë Buxhetore. Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të pasojnë qarkore të tjera shtesë deri në finalizimin e buxhetit për vitin pasues dhe vlerësimet për dy vitet tjera²⁰.

Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i komunës duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t'i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi:

- tavanet e shpenzimeve të aplikueshme për departamentin përkatës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime mbi këto tavane për dy (2) vitet e ardhshme fiskale, dhe
- metodologjinë dhe formularët që duhet të shfrytëzohen nga departamenti përkatës gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal.

Qarkorja buxhetore duhet të përfshijë²¹:

- procedurat që duhet përdorur nga departamenti gjatë përgatitjes së propozim buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore;

- të dhënat të cilat duhet të parashtrohen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore;

- detale mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore; dhe

- afatin e fundit deri në të cilin departamenti duhet të përfundojë dhe t'i dorëzojë ZKF-së propozim buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

Pasi skadimit të afatit kohor të përcaktuar në qarkoren e brendshme buxhetore, ZKF duhet:

- të shqyrtojë propozim-buxhetet dhe kërkesat për ndarje buxhetore të cilat janë dorëzuara nga departamentet komunale, dhe

- të mbajë takime me secilin departament me qëllim të shqyrtimit dhe kuptimit të propozim-buxhetit dhe të departamenteve përkatëse si dhe për të bërë përpjekje për zgjidhjen e çështjeve dhe shqetësime që kanë të bëjnë me propozim-buxhetin, veçanërisht sa ka të bëjë me përputhshmërinë e propozim-buxhetit me Tavanet e Brendshme Komunale të Shpenzimeve dhe qarkoren buxhetore komunale.

Pas mbajtjes së takimeve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni, ZKF duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kryetarit të Komunës Buxhetin e propozuar Komunal për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësime për dy (2) vitet e ardhshme fiskale. Këto dokumente duhet të dorëzohen në formën e cila është në pajtim me qarkoren buxhetore të nxjerrë nga Ministri. ZKF duhet që njëkohësisht t'u shpërndajë departamenteve komunale të komunës propozim-buxhetin për vitin e ardhshëm fiskal²².

Praktikat e deritanishme në Kosovë

Në vazhden e përpjekjeve për të siguruar respektimin e legjislacionin në fuqi, komunitat gjatë vitit 2020 kanë përshtatur

19 Po aty Neni 58, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

20 Shih Nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

21 Qarkorja(et) buxhetore - dokumente ku shtjellohen politikat e MF-së në lidhje me aspekte të ndryshme të procesit buxhetor, informatat të cilat i nevojiten organizatave buxhetore për pjesëmarrje në procesin buxhetor, kërkesat fiskale procedurale të cilat duhet të ndiqen nga ato dhe formularët e udhëzimit e hollësishme për kryerjen e tyre.

22 Neni 60 i Ligjit Nr. 05/L-063 për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr.03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr.04/L-194, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>



Referuar të dhënave për numrin e takimeve publike, për qëllime të diskutimeve buxhetore, konsultime me qytetarë janë mbajtur në



26 komuna,

me gjithsej **198 takime** te realizuara për buxhet dhe KAB, apo mesatarisht **7 takime** për komunë.

Si rrjedhojë,



kanë arritur të miratojnë me kohë propozim-buxhetet në kuvendet e tyre.

strategjitë për mbajtjen e diskutimeve publike me qytetarë për shkak të masave të pandemisë, përmes shfrytëzimit të platformave online të komunikimit. Një pjesë e takimeve për projekt akte, buxhet, apo dokumente të tjera të politikave janë mbajtur në formë fizike por edhe online. Referuar të dhënave për numrin e takimeve publike, për qëllime të diskutimeve buxhetore, konsultime me qytetarë janë mbajtur në 26 komuna, me gjithsej 198 takime te realizuara për buxhet dhe KAB, apo mesatarisht 7 takime për komunë. Si rrjedhojë, 88.95% e komunave kanë arritur të miratojnë me kohë propozim-buxhetet në kuvendet e tyre.²³

Në bazë të hulumtimeve të kësaj fushe, arsyet e mospjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike, krahas pandemisë, kryesisht lidhen me: mos planifikimin e mirëfilltë të konsultimeve publike; mungesën e koordinimit dhe zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik, **mos përgatitjen e raporteve për rezultatet e konsultimit publik ku kontribut-dhënësve u jepen informata për pranimin ose jo të propozimeve të tyre; mungesën së një debati të strukturuar përgjatë konsultimeve; sistemimit jo të duhur të dokumenteve dhe informatave bazë në platformat online, mos prezencës së stafit politik në takime publike, si dhe mosshfrytëzimit të formave alternative për marrjen e pikëpamjeve të lokaliteteve.**²⁴

Sipas legjislacionit në fuqi, pas dorëzimit të projekt buxhetit për vitet vijuese nga ekzekutivi / kryetari i komunës, kuvendet e komunave kanë për obligim të organizojnë enkas dëgjimet buxhetore për projekt buxhetin e komunës. Nga

të dhënat e vitit 2020, shumica dërrmuese e kuvendeve të komunave nuk arritën të përmbushin obligimin e tillë ligjor në organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve për projekt buxhetin e komunës. Nga tridhjetë e tetë (38) komunat e Kosovës vetëm gjashtëmbëdhjetë (16) prej tyre kanë përmbushur këtë obligim ligjor duke organizuar dhe mbajtur dëgjimet buxhetore derisa njëzet e dy (22) kuvende të komunave nuk kanë organizuar dhe mbajtur asnjë dëgjim buxhetore të parapara sipas legjislacionit në fuqi për projekt buxhetin e vitit 2021. Kuvendi i komunës së Dragashit, Ferizajt, Mitrovicës së Jugut, Shtërpçës, Suharekës, Gjilanit, Kamenicës, Istogut, Obiliçit, Shtimës, Podujevës, Vitisë, Fushë Kosovës, Skenderajt, Malishevës, Prizrenit, Mamushës, Klinës, Deçanit, Junikut, dhe Hani i Elezit, janë komunat të cilat nuk kanë organizuar dhe mbajtur asnjë dëgjim buxhetor për projekt buxhetin e vitit 2021 gjatë muajt shtator të viti 2020.²⁵

Përderisa komunat në përgjithësi i përmbahen kërkesave minimale ligjore për përgatitjen e planit buxhetor, kishte mungesë të kuptuarit të përgjegjësive të dëgjimit buxhetor ndërmjet drejtuesve komunalë dhe asambleve.²⁶ Sfidë tjetër e komunave mbetet, mënyra jo e duhur e informimit të qytetarëve për dëgjime buxhetore. Komunat zakonisht informatën për dëgjime buxhetore e plasojnë në ueb faqen zyrtare të saj, apo në rrjete sociale (kryesisht në fb), e që konsiderojmë që informimi i tillë është i mangët, duke patur parasysh mënyrat dhe format tjera nga më të ndryshmet për të inkomporu edhe qytetarët në këto dëgjime.

23 Raporti i performancës së komunave të Republikës së Kosovës 2020, MAPL, 2021, fq. 16, <https://mapl.rks-gov.net/performance-komunale/>

24 Po aty fq.16-17, <https://mapl.rks-gov.net/performance-komunale/>

25 Transparometri komunal & transparenca e komunave në retrospektivë, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), 2021, Fq.17, <https://kdi-kosova.org/publikimet/transparometri-komunal-2020-transparenca-e-komunave-ne-retrospektive/>

26 Po aty <https://kdi-kosova.org/ep-content/uploads/2020/02/93-Raporti-Municipal-Budget-Development-Process-in-Kosovo-ALB-01.pdf>



5. MODELET DHE PRAKTIKAT E MIRA NË ORGANIZIMIN E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE

Modeli Porto Alegre:

Buxhetimi me pjesëmarrje si ndryshim politik radikal. Modeli i Porto Alegre është programi më i njohur dhe më i dalluar i buxhetimit me pjesëmarrje. Duke filluar nga viti 1989 në komunën e Porto Alegre, me iniciativën e Partisë së sapa zgjedhur të Punëtorëve, ai është përhapur që atëherë në pothuajse 100 komuna në Brazil dhe është zbatuar në nivel shtetëror në Rio Grande do Sul. Schneider dhe Goldfrank (2001) kanë demonstruar se si programi është zgjeruar me sukses nga niveli komunal në atë shtetëror në Brazil, me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qindra mijëra njerëzve.

Megjithatë, BP ende nuk është zbatuar në nivel kombëtar dhe nuk planifikohet që kjo të ndodh në këtë fazë. Ai shihet gjerësisht si një eksperiment i suksesshëm në demokracinë pjesëmarrëse, i cili ka kontribuar në synimet e reduktimit të varfërisë duke rritur besimin në institucionet publike. Si rezultat, ai ka tërhequr mbështetjen e grupeve duke fillu-

ar nga Banka Botërore deri te partitë politike me prirje të majtë. Duke u përqendruar në fazën e formulimit të ciklit të BP, modeli i Porto Alegre përfshin gjithashtu analizën e buxhetit, gjurmimin dhe monitorimin e aktiviteteve.

Nën buxhetimin me pjesëmarrje të stilit të Porto Alegre, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile marrin pjesë drejtpërdrejt në marrjen e vendimeve buxhetore përmes një cikli njëvjeçar të forumeve masive të qytetarëve, **asambleve tematike që trajtojnë çështje specifike, si shëndetësia dhe arsimi, dhe zgjedhjen e delegatëve të përkushtuar qytetarë, të cilët formojnë një Këshill të Buxhetimit me Pjesëmarrje, i cili shqyrton propozimin përfundimtar të buxhetit.** Procesi përdoret për alokimin e burimeve buxhetore (duke përdorur një skemë sasiore për t'i prioritetizuar shpenzimet sipas nevojave dhe preferencave), caktimin e prioritetëve të gjera të politikave sociale dhe ekonomike dhe monitorimin e shpenzimeve publike.²⁷

²⁷ Heimans, Jeremy. Strengthening participation in public expenditure management: policy recommendations for key stakeholders. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), 2002, fq. 6. Linku: <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/640564834060.pdf?expires=1647013427&id=id&>





Qytetarët votojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për prioritetet në nevojë për investime. Në takimet në fjalë zgjidhen dhe komisionarët me bazë njësie, të cilët ndihmojnë në realizimin sa më transparent të buxhetimit me pjesëmarrje. Në takimet vijuese të komisionarit dhe stafit të bashkisë, bëhet vlerësimi i prioriteteve nëpërmjet përcaktimeve të kërkuara nga rregullorja e buxhetimit me pjesëmarrje.

Modeli i Bashkisë së Elbasanit

Planifikimi i buxhetit ku komuniteti informohet sa do të jetë vlera e investimit që do të prekë njësinë përkatëse ku prezantohet ky buxhet, dhe nëse banorët kërkojnë ndryshime të investimeve, këto regjistrohen dhe më pas përfshihen në zërin e buxhetit përfundimtar. Minimumi i kriterit që një proces të quhet buxhetim me pjesëmarrje është pjesëmarrja direkte e qytetarëve. Bashkia që praktikon në mënyrën më të suksesshme këtë mekanizëm, është ajo e Elbasanit, ku procesi i buxhetimit fillon me informimin e publikut me anë të mediave lokale, posterave të vendosur pranë çdo njësie administrative dhe ftesave të shpërndara në pothuajse të gjitha familjet. Për organizimin e pjesëmarrjes qytetare angazhohen administratorët e njësisve administrative dhe aktorë nga shoqëria civile.

Në takimet publike të realizuara për çdo njësi, në vendin e caktuar paraprakisht nga administratori, **qytetarët votojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për prioritetet në nevojë për investime. Në takimet në fjalë zgjidhen dhe komisionarët me bazë njësie, të cilët ndihmojnë në realizimin sa më transparent të buxhetimit me pjesëmarrje. Në takimet vijuese të komisionarit dhe stafit të bashkisë, bëhet vlerësimi i prioriteteve nëpërmjet përcaktimeve të kërkuara nga rregullorja e buxhetimit me pjesëmarrje.**²⁸

Modeli i komunave në Gjermani

Në rrjedhën e modernizimit administrativ, disa komuna të Gjermanisë së Jugut përdorën për herë të parë instrumentin e buxhetit të qytetarëve. Eksperimenti i parë me buxhetimin me pjesëmarrje në Gjermani u zhvillua në vitin 1998 në komunën e Mönchweiler (Baden-Wuerttemberg), një qytet i vogël me 3,200 banorë. Kishte të bënte me “një procedurë të zgjeruar të pjesëmarrjes së qytetarëve” në diskutimin e planit buxhetor të vitit 1999, përpara vendimit përfundimtar të këshillit. Propozimet e bëra nga qytetarët u dokumentuan - sipas një liste kontrolluese të përpiluar nga jashtë -, u diskutuan publikisht në këshill dhe pjesërisht u transferuan në buxhet. Meqenëse kjo procedurë mbeti unike në Mönchweiler, ajo nuk mund të cilësohet si buxhet me pjesëmarrje.

Ideja për buxhetet e qytetarëve u forcua kur gjeti mbështetës përkatës joshitetërorë. Ata mbajtën rrjetin “Komunat e së Ardhmes” për t’i mbështetur komunat e gatshme për reforma gjatë shndërrimit të ideve të tyre, për të shkëmbyer përvoja dhe për ta bërë të mundur mësimin e ndërsjellë (shih Bertelsmann Stiftung et al. 2002). Rrjeti ka ekzistuar ndërmjet viteve 1998 dhe 2002. Projekti më i madh i buxhetit të qytetarëve në këtë kontekst u realizua nga Ministria e Brendshme e shtetit federal gjerman North Rhine-Westphalia ndërmjet viteve 2000 dhe 2004 në bashkëpunim me Fondacionin

accname=guest&checksum=1314D93CA3C3C7C98A9CE3CBD9FFE957

28 Udhërrëfyes për përfshirjen e qytetarëve / komuniteteve në qeverisjen vendore. Instituti Për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi – IDRA, 2017, fq. 48- 49.

Bertelsmann në gjithsej gjashtë komuna (Castrop Rauxel, Hamm, Hilden, Monheim am Rhein, Voltho dhe Emsdetten) (shih Innenministerium NRW 2004: 6). Komunat e përfshira fituan shumë përvoja dhe zhvilluan ide inovative duke testuar buxhetet pjesëmarrëse për dy vite. Për fat të keq, projekti la vetëm efekte më pak të qëndrueshme. Pas përfundimit të tij dhe përcaktimit të mbështetjes financiare të jashtme, komunat Castrop-Rauxel, Hamm, Monheim am Rhein dhe Voltho ndërprejnë buxhetimin me pjesëmarrje. Për fat të mirë, komunat e Groß-Umstadt, Emsdetten dhe Hilden vazhduan buxhetimin me pjesëmarrje deri më sot. Qytete të tjera si Köln frymëzohen nga eksperimenti.

Pjesë e reformave pjesëmarrëse: Frymëzuar nga ideja e demokracisë pjesëmarrëse që nga viti 2000, në kryeqytetin gjerman, Berlin, (i cili është në të njëjtën kohë një shtet federal dhe një komunë unitare) dhe ndarjet administrative (ang. borough) të tij filloi një debat mbi buxhetet pjesëmarrëse. Në vitin 2002 u krijua një grup punues "Buxheti me pjesëmarrje i Berlinit", i formuar nga planifikues të qytetit, aktivistë të lëvizjes Agjenda 21 dhe shkencëtarë socialë për ta zhvilluar një koncept të buxhetimit publik për Berlinin dhe ndarjet administrative të tij (shih AG Bürgerhaushalt Berlin 2002, Herzberg 2003, 2004). Disa fondacione të partive politike dhe fondacioni federal për edukim politik dhanë mbështetje të jashtme. Gjithashtu, në Berlin prezantimi i buxheteve të qytetarëve plotëson kushte të favorshme, sepse që nga viti 1994 u prezantua një sistem i ri i kontabilitetit dhe performancës së kostos si elementi kryesor i reformës administrative. (shih Fock 2004) Që nga viti 2004, qeveria e Berlinit krijoi gjithashtu një buxhet të bazuar në produkt të orientuar drejt prodhimit. Pas dështimit të disa pilot projekteve, në vitin 2006 filluan projektet e para të buxheteve me pjesëmarrje me ndarjet administrative Berlin-Lichtenberg dhe Berlin-Hellersdorf-Marzahn. Deri më tani, Berlini dhe ndarjet administrative të tij janë një nga pikat kyçe të buxhetimit me pjesëmarrje në Gjermani.²⁹

Berlin-Lichtenberg formoi për buxhetin e tij të parë qytetar 2007 një grup inovativ të institucioneve drejtuese (shih Weise 2006). Ky model ndërkohë shpesh kopjohet nga projekte të tjera të buxhetit me pjesëmarrje në Gjermani. Katër komitete bashkëpunuan në kuadër të buxhetit të qytetarëve në Berlin Lichtenberg:

- Ekipi menaxhues i projektit funksiononte si organ i brendshëm koordinues brenda administratës së ndarjes administrative, duke përfshirë drejtorët e shërbimit drejtues si dhe të shërbimeve personale dhe financiare të administratës së ndarjes administrative.
- U krijua një komitet drejtues si organ qendror vendim-marrës me shtatë anëtarë: tre nga administrata e ndarjes administrative (përfshirë kryetarin e komunës) dhe katër që përfaqësonin katër grupet parlamentare të kuvendit të ndarjes administrative. Nën drejtimin e saj dhe së bashku me komitetet e tjera u zhvillua koncepti i buxhetit të qytetarëve dhe u përcaktua "rregullorja e punës". Komiteti drejtues pranoi rezultatet e ekipit të projektit dhe vendosi unanimisht për kërkesat për zgjidhje.
- Ekipi i projektit si organ punues u themelua me 12 anëtarë me të drejta të barabarta: katër përfaqësues të qytetarëve (nga degët për rini, të moshuar, migrantë dhe gra), katër këshilltarë të ndarjes administrative dhe katër përfaqësues të njërive të përfshira administrative të ndarjes administrative.
- Ekipi redaktues për analizimin dhe plotësimin e sugjerimeve të qytetarëve përfshiu dhjetë qytetarë, të cilët u përzgjedhën në pesë takimet tremujorëve. Ata morën mbështetje nga nëpunësit civilë të administratës së ndarjes administrative.

Nga ana tjetër, një formë e decentralizuar e drejtimit të procedurës së buxhetit me pjesëmarrje pa komitete të veçanta u krijua në Berlin-Marzahn-Hellersdorf. Që nga viti 2008, të nëntë qarqet (lagjet) e ndarjes administrative dhe "Zyra për fëmijë dhe të rinj" e organizojnë procedurën dhe bashkëpunojnë ngushtë me administratën e ndarjes administrative. Propozimet në diskutimin e buxhetit të qytetarëve mblidhen nga qendrat e qarqeve dhe në fund i dorëzohen administratës së ndarjes administrative. Mbi këtë bazë hartohet një rezolutë për këshillin e ndarjes administrative. Komentet kthyesë nga qytetarët merren gjatë takimeve me qytetarët.³⁰

29 Jochen, Franzke. Best Practice of Participatory Budgeting in Germany – Chances and Limits (Praktika më e Mirë e Buxhetimit me Pjesëmarrje në Gjermani – Mundësitë dhe Kufizimet), qershor 2018, https://www.researchgate.net/publication/254438847_Best_Practice_of_Participatory_Budgeting_in_Germany_-_Chances_and_Limits

30 Po aty



6. REKOMANDIMET PËR KOMUNA

- 1** Ministria e Administrimit Pushtetit Lokal (MAPL), të dizajnoj një udhëzues model për komunat me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve të ndryshme në ndërtimin e mekanizmave operues për planifikimin e buxhetit me pjesëmarrje qytetare. Kombinimi i modelit të Porto Alegros, bashkisë së Elbasanit si dhe model Gjerman, duke ju përshtatë kontekstit lokal / komunave të Kosovës do të ishte një lehtësi e madhe për zbatim të plotë të Buxhetimit me Pjesëmarrje nga ana e Komunave.
- 2** Komunat të rrisin komunikimin me qytetarët pjesëmarrës në dëgjimet buxhetore me qëllim të informimit të tyre për statusin e kërkesave të parashtruara gjatë dëgjimeve buxhetore.
- 3** Anëtarët e kuvendeve të komunave të rrisin angazhimin e tyre në proces të planifikimit të buxhetit komunal sidomos në nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve të caktuara qytetarë në organizimin e dëgjimeve buxhetor në nivel komune.
- 4** Kuvendi i komunës të luaj rolin mbikëqyrës të procesit të planifikimit të buxhetit me pjesëmarrje dhe të kërkojë llogaridhënie nga ana e ekzekutivit / kryetarit për procesin e planifikimit të buxhetimit me pjesëmarrje dhe ofrimin e raporteve mbi pranueshmërinë e kërkesave të qytetarëve në planifikimet buxhetore.
- 5** Institucionet lokale të krijojnë partneritete me mekanizma të ndryshëm Organizatat e Shoqërisë Civile me qëllim të nxitjes dhe përfshirjes së grupeve të marginalizuara në planifikimin e buxhetit komunal.





7. BURIMET

- 1 Shah, Anwar. Participatory budgeting. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Banka Botërore.
- 2 Silverlock, Leslie. Participatory Budget Associate. A Toolkit for Participatory Budgeting in the UK Second Edition, Second Edition, janar 2010.
- 3 *Participatory budgeting toolkit for local governments in Albania (English)*. Washington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore.
- 4 Heimans, Jeremy. Strengthening participation in public expenditure management: policy recommendations for key stakeholders. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), 2002.
- 5 Procesi i zhvillimit të buxheteve komunale në Kosovë 2019, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).
- 6 Raporti i performancës së komunave të Republikës së Kosovës 2020, MAPL, 2021.
- 7 Transparometri komunal & transparenca e komunave në retrospektivë, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), 2021.
- 8 Ligji Nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin
- 9 Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale
- 10 Udhëzimi Administrativ Nr. 06 / 2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna
- 11 Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna





Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT) është themeluar në vitin 2020, në përbërje të disa organizatave lokale duke përfshirë: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, OJQ IQS, OJQ SHIP, OJQ FOJK si dhe KDI. AQT gjatë vitit 2021 është plotësuar edhe me anëtarë të rinj për të mbuluar komunat e rajonit të Prishtinës (Initiative for Social Education - ISEP), komunat e rajonit të Ferizajt (OJQ Avonet), komuna e rajonit të Gjakovës (SHL-Kosova), komunat e rajonit të Prizrenit (OJQ Sofra). AQT ka për synim të avokoj dhe llojoj tek institucionet lokale dhe qendrore në rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien institucionale.

Me përkrahjen financiare të:

